

MBËSHËTETJA FAMILJARE, MBËSHËTETJA NGA SHKOLLA DHE VETËEFIKASITETI PËR
KARRIERË TEK ADOLESHENTËT

MBËSHËTETJA FAMILJARE, MBËSHËTETJA NGA SHKOLLA
DHE VETËEFIKASITETI PËR KARRIERË TEK
ADOLESHENTËT

TEMA PËR TITULLIN MASTER I ARTEVE
NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

LEUTRIM EDIPI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIMI
PRISHTINË

QERSHOR, 2022

MBËSHËTETJA FAMILJARE, MBËSHËTETJA NGA SHKOLLA DHE VETËEFIKASITETI PËR KARRIERË TEK ADOLESHENTËT

Leutrim Edipi

Mentori: Prof. Ass. Dr. Liridona Jemini-Gashi.

Në mesin e shumë proceseve e ndryshimeve që shpërfaqen e shoqërojnë periudhën e adoleshencës, hyn edhe vendimarrja për orientim në karrierë. Ekzistojnë shumë faktorë që ndikojnë në procesin e zhvillimit të karrierës gjatë gjithë jetës. Literatura ekzistuese sygjeron që statusi i vendimarrjes për karrierë është i ndërlidhur me faktor që përfshijnë mbështetjen sociale dhe vetëefikasitetin. Pra, investimi në të kuptuarit e të këtyre dhe faktorët tjerë ndikues në vendimarrje për orientim në karrierë, është mjaft relevant dhe i domosdoshëm për zhvillimin dhe zbatimin e duhur të praktikave cilësore.

Prandaj, qëllimi i realizimit të këtij hulumtimi është që të analizojë ndërlidhjen midis mbështetjes familjare, mbështetjes nga shkolla dhe vetëefikasitetit për karrierë tek adoleshentët. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 131 maturantë nga shkollat e mesme të rajoneve të ndryshme të Kosovës, prej të cilëve 30 djem dhe 101 vajza, me moshë mesatare 17.9 vjec.

Duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës janë parashtruar këto pyetje kërkimore të cilat ky hulumtim do të përpiqet t'i adresojë:

1. Cila është ndërlidhja në mes të mbështetjes familjare, mbështetjes nga shkolla dhe vetëefikasitetit për karrierë tek adoleshentët?
2. Sa adoleshentë kosovarë kanë vendosur për profesionin e tyre të ardhshëm?
3. A ka dallime gjinore në mbështetje familjare, shkolla dhe vetëefikasitet në mesin e adoleshentëve ?

Në bazë të hulumtimeve paraprake, hipotetizojmë që ekziston ndërlidhje pozitive në mes të mbështetjes familjare, mbështetjes nga shkolla dhe vetëefikasitetit për karrierë tek adoleshentët. Përpos kësaj, konsiderojmë që ekzistojnë dallime gjinore në mbështetje familjare, shkolla dhe vetëefikasitet për karrierë në mesin e adoleshentëve. Ndërsa, sa i përket vendosshmërisë për karrierë, supozojmë që një pjesë e madhe e adoleshentëve kosovarë kanë vendosur për profesionin e tyre të ardhshëm.

Sipas Teorisë social kognitive të karrierës, procesi i zgjedhjes së karrierës shihet si një ndërveprim kompleks midis një numri variablash. Këto variabla përfshijnë variablat njohëse (vetë-efikasiteti dhe rezultatet e pritura), kontekstuale (mbështetja sociale dhe pengesat në karrierë) dhe personale (përkatësia etnike dhe statusi i aftësisë së kufizuar). Ndërveprimi ndërmjet këtyre variablave mund të nxisë ose bllokojë zgjedhjet e karrierës së të rinjve (Lent et al, 2000).

Metoda e mostrimit do të jetë joprobabile, i qëllimshëm, pra maturantë të shkollave, me

MBËSHTETJA FAMILJARE, MBËSHTETJA NGA SHKOLLA DHE VETËEFIKASITETI PËR KARRIERË TEK ADOLESHENTËT

metoden kuantitative e hulumtimit. Për vetëefikasitetin është përdorur pyetësi Betz që përmban gjithsej 25 pyetje. Ndërsa për mbështetjen sociale janë përdorur gjashtë pyetje, që kanë matur nivelin e diskutimit të nxënësve me mësimitdhënësit e tyre lidhur me planet për karrierë, inkurajimin që mësimitdhënësit mund t'u japin nxënësve të tyre për profesionin e zgjedhur, si dhe ofrimin e informatave rreth profesionit që nxënësit kanë zgjedhur (Allison & Cossette, 2007).

Në bazë të analizave deskriptive shohim se nga numri i përgjithshëm prej 131 respondentëve, 120 prej tyre kanë vendosur për profesionin e tyre të ardhshëm, ndërsa 11 kanë raportuar që nuk kanë vendosur. Duke u bazuar në hipotezën tjetër, rezultatet e T-Test-it tregojnë që nuk ka dallime gjinore në mes mbështetjes familjare dhe vetëefikasitetit, ndërsa evidentohet që ekzistojnë dallime gjinore sa i përket mbështetjes nga shkolla ku shihet se sipas mesatares djemtë (11.26), shprehin mesatare më të lartë në këtë variabël se sa vajzat (9.83), $t(131) = 1.877, p = .063$.

Sa i përket korelacionit mes variablave, rezultatet tregojnë se ekziston një ndërlidhje signifikante pozitive në mes të mbështetjes familjare dhe mbështetjes nga shkolla, $r(131) = .226, p < .01$. Poashtu, ekziston një ndërlidhje signifikante pozitive në mes të mbështetjes familjare dhe vetëefikasitetit, $r(131) = .461, p < .01$. Për më tepër, ekziston ndërlidhje në mes të mbështetjes nga shkolla dhe vetëefikasitetit, $r(131) = .306, p < .01$.

Regresioni linear tregon që variabla e mbështetjes nga familja te respondentët parashikon në mënyrë signifikante vetëefikasitetin, dhe shpjegon 20.6 % në ndryshueshmërinë e vetëefikasitetit. Ndërsa, regresioni tregon që variabla e mbështetjes nga mësimitdhënësit te respondentët parashikon në mënyrë signifikante vetëefikasitetin, dhe shpjegon 8.7 % në ndryshueshmërinë e vetëefikasitetit.

Këto rezultate mbështeten edhe nga gjetjeve të shumë studimeve, sipas të cilëve adoleshentët të cilët kanë pasur mbështetje nga familja, sidomos nga prindërit, duke pasur mbështetje, dashuri, komunikim dhe ngrohtësi kanë treguar një zhvillim më të plotë mbi karrierën dhe gatishmëri më të madhe për vendimmarrje (Ferry, 2006). Vërejmë që korelacion të lartë kemi edhe në variablën e mbështetjes nga mësimitdhënësit dhe vetëefikasitetit, ku edhe në një hulumtim me 9,702 nxënës të shkollave të mesme urbane dhe rurale u gjet se mbështetja e mësuesve ra gjatë viteve të shkollës së mesme dhe se kjo kishte efekte negative në besimet e vetë-efikasitetit të nxënësve (Michel & DellaMattera, 2010). Regresioni linear tregon që variabla e mbështetjes nga familja dhe mësimitdhënësit te respondentët parashikon në mënyrë signifikante vetëefikasitetin. Sipas Allison & Cossette, (2007) të rinjtë që raportuan se kishin marrur më shumë mbështetje sociale nga ana familjes dhe shkollës, treguan zhvillim më të mirë të karrierës dhe besim më të

MBËSHTETJA FAMILJARE, MBËSHTETJA NGA SHKOLLA DHE VETËEFIKASITETI PËR KARRIERË TEK ADOLESHENTËT

madh në vendimet që ata ndërmerjnë, në krahasim me ata që kishin marrur më pak mbështetje.

Në bazë të shqyrtimit të literaturës dhe rezultateve të hulumtimit tonë, konkludojmë që ekziston ndërlidhje e fuqishme midis vetëefikasitetit, mbështetjes nga shkolla dhe mbështetjes nga familja në mesin e adoleshentëve. Për më tepër, konkludojmë që mbështetja nga familja dhe shkolla ka impakt dhe parashikon në mënyrë signifikante vetëefikasitetin e adoleshentëve.

Rekomandojmë që duhet adresuar si nevojë imediate, në koordinim me institucionet dhe politikbërësit relevant, ngritja e kapaciteteve profesionale të mësimitdhënësve dhe akterëve të shkollave në raport me rëndësinë e orientimit në karrierë dhe rolin e mbështetjes sociale në vetëefikasitetin e të rinjve. Për më tepër, rekomandohet që edhe prindërve të u ofrohen programe trajnimi për njohje të kapaciteteve të fëmijëve të tyre, tiparet e personalitetit, interesat, vlerat etj. Poashtu, sesione informuese praktike duhet të mbahen në shkolla me nxënësit duke i ofruar informacione mbi profesionet, duke i stimuluar ata që të realizojnë teste psikologjike dhe takime reflektuese me psikologët shkollorë.